

31992L0013

Direktivë e Këshillit 92/13/KEE, datë 25 shkurt 1992, që koordinon ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative në lidhje me zbatimin e rregullave komunitare për procedurat e prokurimit të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në sektorin ujqor, energjetik, të transportit dhe të telekomunikacionit

Gazeta Zyrtare L 076, 23/03/1992 faqe 0014 – 0020
Botimi i veçantë finlandez: Kapitull 6 Vëllimi 3 f. 0127

Botimi i veçantë suedez: Kapitulli 6 Volumi 3 fq. 0127

Direktivë e Këshillit 92/13/KEE, datë 25 shkurt 1992, që koordinon ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative në lidhje me zbatimin e rregullave komunitare për procedurat e prokurimit të subjekteve që veprojnë në sektorin ujqor, energjetik, të transportit dhe të telekomunikacionit

KËSHILLI I KOMUNITETEVE EUROPIANE,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit Ekonomik Europian dhe në veçanti nenin 100 shkronja (a) të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit [1],

Në bashkëpunim me Parlamentin Europian [2],

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social [3],

Duke pasur parasysh se Direktiva e Këshillit 90/531/KEE, datë 17 shtator 1990, për procedurat e prokurimit të subjekteve që veprojnë në sektorin ujqor, energjetik, të transportit dhe të telekomunikacionit [4] përcakton rregulla për procedurat e prokurimit me qëllim që të sigurojë që furnizuesve dhe sipërmarrësve të mundshëm t'u jepet e njëjta mundësi për të siguruar fitimin e kontratave, por nuk përmban dispozita specifike për të siguruar zbatimin e efektshëm të saj;

Duke pasur parasysh se rregullat ekzistuese si në nivel kombëtar ashtu dhe në nivel komunitar për sigurimin e zbatimit të saj nuk janë gjithmonë të përshtatshme;

Duke pasur parasysh se mungesa e masave të efektshme korigjuese ose papërshtatshmëria e masave korigjuese ekzistuese mund t'i pengojë sipërmarrjet e Komunitetit të paraqesin oferta; duke pasur parasysh se, rrjedhimisht, Shtetet Anëtare duhet ta zgjidhin këtë situatë;

Duke pasur parasysh se Direktiva e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989, për koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të shqyrtimit për dhënien e kontratave [5] të furnizimit dhe punëve publike, kufizohet në procedurat e dhënies së kontratave brenda fushës së veprimit të Direktivës së Këshillit 71/305/KEE, datë 26 korrik 1971, në lidhje me koordinimin e procedurave për shpalljen e kontratave fituese për punë publike [6], të ndryshuar së fundi nga Direktiva 90/531/KEE, dhe Direktivës së Këshillit 77/62/ KEE, datë 21 dhjetor 1976, që koordinon procedurat për shpalljen e kontratave publike fituese për furnizime [7], të ndryshuar së fundi nga Direktiva 90/531/ KEE;

Duke pasur parasysh se hapja e prokurimit në sektorët përkatës për konkurrencën në Komunitet nënkupton miratimin e dispozitave për të siguruar që procedurat e duhura të shqyrtimit të vihen në dispozicion të furnizuesve ose sipërmarrësve në rast të shkeljes së legjislacionit komunitar përkatës, ose rregullave kombëtare në zbatim të këtij legjislacioni;

Duke pasur parasysh se është e nevojshme të parashikohet një rritje thelbësore e garancive për transparencë dhe mosdiskriminim dhe duke pasur parasysh se, për të pasur ndikim të prekshëm, duhet të vihen në dispozicion masa korrigjuese të efektshme dhe të shpejta;

Duke pasur parasysh se duhet të mbahet parasysh natyra e veçantë e ndonjë rendi juridik duke i lejuar Shtetet Anëtare të zgjedhin ndërmjet kompetencave të ndryshme për organet e shqyrtimit me efekt të njëjtë;

Duke pasur parasysh se një nga këto alternativa përfshin kompetencën për të ndërhyrë drejtpërdrejt në procedurat e prokurimit të autoriteteve kontraktuese nëpërmjet pezullimit ose shfuqizimit të vendimeve, apo dispozitave diskriminuese në dokumente ose publikime;

Duke pasur parasysh se alternativa tjetër parashikon kompetencën për të ushtruar presion të tërthortë të efektshëm mbi autoritetet kontraktuese, për t'i bërë që të korrigjojnë çdo shkelje ose për t'i penguar të mos bëjnë shkelje dhe për të parandaluar dëmin;

Duke pasur parasysh se kërkesat për dëmshpërblime duhet të jenë gjithmonë të mundshme;

Duke pasur parasysh se nëse bëhet një kërkesë për dëmshpërblim që paraqet kostot e përgatitjes së një oferte ose të pjesëmarrjes në një procedurë prokurimi, personit që bën kërkesën, me qëllim që të rimbursohet për koston, nuk i kërkohet të provojë që ai do të kishte fituar kontratën nëse nuk do të ishte kryer shkelja;

Duke pasur parasysh se autoritetet kontraktuese që respektojnë rregullat e prokurimit mund ta bëjnë këtë të ditur nëpërmjet mjeteve të duhura; duke pasur parasysh se kjo kërkon shqyrtim nga persona të pavarur të procedurave dhe praktikave të prokurimit, të zbatohen nga këto autoritete;

Duke pasur parasysh se për këtë qëllim është e përshtatshme të krijohet një sistem vërtetues, që bën të mundur përfshirjen e një deklaratë për zbatimin korrekt të rregullave të prokurimit në njoftimet e publikuara në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane;

Duke pasur parasysh se autoritetet kontraktuese duhet të kenë mundësinë t'i drejtohen sistemit vërtetues, nëse duan; duke pasur parasysh se Shtetet Anëtare duhet t'ua ofrojnë këtë mundësi; duke pasur parasysh se ato mund ta bëjnë këtë ose duke e krijuar vetë sistemin ose duke i lejuar autoritetet kontraktuese që t'i drejtohen sistemit vërtetues të krijuar nga një Shtet tjetër Anëtar; duke pasur parasysh se ato mund ta delegojnë detyrën e kryerjes së shqyrtimit sipas sistemit vërtetues tek persona, profesione ose personel i institucioneve;

Duke pasur parasysh se fleksibiliteti i nevojshëm në prezantimin e një sistemi të tillë garantohet me përcaktimin e kërkesave thelbësore për të në këtë direktivë; duke pasur parasysh se hollësitë operative duhet të jepen në standardet europiane të cilave u referohet kjo direktivë;

Duke pasur parasysh se Shteteve Anëtare mund t'u duhet t'i përcaktojnë hollësitë operative përpara ose krahas rregullave që përmbajnë standardet europiane;

Duke pasur parasysh se nëse sipërmarrjet nuk kërkojnë shqyrtim, disa shkelje nuk mund të korrigjohen nëse nuk vihet në përdorim një mekanizëm specifik;

Duke pasur parasysh se, në këtë rast, Komisioni, kur mendon që është kryer një shkelje e qartë dhe flagrante, gjatë procedurës së prokurimit, duhet të jetë në gjendje ta sjellë në vëmendje të autoriteteve kompetente të Shtetit Anëtar dhe të autoritetit kontraktues në fjalë, në mënyrë që të merren hapat e duhura për korrigjimin e shpejtë të kësaj shkeljeje;

Duke pasur parasysh se është e nevojshme të parashikohet mundësia e pajtimit në nivel komunitar për të mundësuar zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mënyrë miqësore;

Duke pasur parasysh se zbatimi në praktikë i kësaj direktive duhet të shqyrtohet në të njëjtën kohë me atë të Direktivës 90/531/KEE në bazë të informacionit që duhet të japin Shtetet Anëtare në lidhje me funksionimin e procedurave kombëtare të shqyrtimit;

Duke pasur parasysh se kjo direktivë duhet të hyjë në fuqi në të njëjtën kohë me Direktivën 90/531/KEE;

Duke pasur parasysh se është e nevojshme që Mbretërisë së Spanjës, Republikës Greke dhe Republikës Portugeze t'u jepet koha e duhur shtesë për të transpozuar këtë direktivë, duke pasur parasysh datat e zbatimit të Direktivës 90/531/KEE në këto vende,

KA MIRATUAR KËTË DIREKTIVË

KREU I

Masat korrigjuese në nivel kombëtar

Neni 1

1. Shtetet Anëtare marrin masat e nevojshme për të siguruar që vendimet e marra nga autoritetet kontraktuese të mund të shqyrtohen me efektshmëri dhe sidomos sa më shpejt që të jetë e mundur, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin e mëposhtme dhe sidomos në nenin 2 pika 8, për të parë nëse këto vendime kanë shkelur të drejtën komunitare në fushën e prokurimit ose rregullat kombëtare në zbatim të kësaj të drejte sa u përket:

(a) procedurave të shpalljes së kontratave fituese brenda fushës së veprimit të Direktivës së Këshillit 90/531/KEE; dhe

(b) respektimit të nenit 3 pika 2 shkronja (a) të asaj direktive në rastin e autoriteteve kontraktuese për të cilat zbatohet kjo dispozitë.

2. Shtetet Anëtare sigurojnë që të mos ketë diskriminim ndërmjet sipërmarrjeve të cilat mund të ankohen për dëm në kontekst të një procedure prokurimi si rezultat i dallimit që bën kjo direktivë ndërmjet rregullave kombëtare në zbatim të së drejtës komunitare dhe rregullave të tjera kombëtare.

3. Shtetet Anëtare sigurojnë që procedurat e shqyrtimit të jenë në dispozicion, sipas rregullave të detajuara që mund të përcaktojnë Shtetet Anëtare, të paktën për çdo person që ka ose ka pasur interes në fitimin e një kontrate të veçantë dhe që është dëmtuar ose rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e mundshme. Shtetet Anëtare, në veçanti, mund të kërkojnë që personi i cili kërkon shqyrtimin të ketë njoftuar paraprakisht autoritetin kontraktues për shkeljen e pretenduar dhe për synimin e tij për të kërkuar shqyrtim.

Neni 2

1. Shtetet Anëtare sigurojnë që masat e marra në lidhje me procedurat e shqyrtimit të specifikuar në nenin 1 të përfshijnë dispozita për kompetencat:
ose

(a) për të marrë, në rastin më të parë të mundshëm dhe me anë të një procedure të ndërmjetme, masa të përkohshme me qëllim korrigjimin e shkeljes së pretenduar, ose parandalimin e dëmit të mëtejshëm ndaj interesave në fjalë, duke përfshirë masa për të pezulluar ose siguruar pezullimin e procedurës së prokurimit ose zbatimin e çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues; dhe

(b) për të shfuqizuar ose për të siguruar shfuqizimin e vendimeve të marra në mënyrë të paligjshme, duke përfshirë heqjen e specifikimeve diskriminuese teknike, ekonomike ose financiare në njoftimin e kontratës, njoftimin periodik tregues, njoftimin për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, ftesën për tender, dokumentet e kontratës, ose çdo dokument tjetër në lidhje me procedurën e prokurimit në fjalë; ose

(c) për të marrë, në rastin më të parë të mundshëm dhe nëse është e mundur me anë të procedurave të përkohshme, dhe nëse është e nevojshme nëpërmjet një procedure përfundimtare për këtë çështje, masa të ndryshme nga ato që parashikohen në shkronjat (a) dhe (b) me qëllim korrigjimin e çdo shkeljeje të identifikuar dhe parandalimin e dëmit ndaj interesave në fjalë; në veçanti, nëpërmjet një urdhër-pagese për shumën e veçantë, në rastet kur shkelja nuk është korrigjuar ose parandaluar.

Shtetet Anëtare mund ta bëjnë këtë zgjedhje ose për të gjitha autoritetet kontraktuese ose për kategoritë e autoriteteve të përcaktuara në bazë të kritereve objektive, duke ruajtur, në çdo rast efikasitetin e masave të përcaktuara për të parandaluar shkaktimin e dëmtimit ndaj interesave të prekura;

(d) dhe, në të dyja rastet e mësipërme, për të dëmshpërblyer personat e dëmtuar nga shkelja. Nëse kërkohet dëmshpërblim për arsye të marrjes së një vendimi të paligjshëm, Shtetet Anëtare, kur e kërkon sistemi i tyre i brendshëm ligjor dhe kur ky i fundit parashikon organe që kanë kompetenca të nevojshme për këtë qëllim, parashikojnë që vendimi i kundërshtuar fillimisht të shfuqizohet ose të shpallet i paligjshëm.

2. Kompetencat e përmendura në pikën 1 mund t'u delegohen organeve të veçanta përgjegjëse për aspekte të ndryshme të procedurës së shqyrtimit.

3. Procedurat e shqyrtimit në vetvete nuk kanë nevojë të kenë një efekt pezullues të menjëhershëm mbi procedurën e prokurimit me të cilën kanë lidhje.

4. Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që, kur gjykojnë të urdhërojnë apo jo masa të përkohshme, organi përgjegjës të mund të marrë parasysh pasojat e mundshme të masave për të gjitha interesat që mund të preken, si dhe interesin publik, dhe të mund të vendosë të mos merren këto masa nëse pasojat e tyre negative i kalojnë përfitimet. Vendimi për të mos marrë masa të përkohshme nuk cenon asnjë pretendim tjetër të personit që kërkon marrjen e këtyre masave.

5. Shuma që duhet paguar në përputhje me nenin 1 shkronja (c) duhet të caktohet në nivel mjaft të lartë për të nxitur autoritetin kontraktues që të mos kryejë ose të mos vazhdojë të kryejë shkelje. PAGESA E KËSAJ SHUME DUHET TË BËHET NË BAZË TË NËJË VENDIMI PËRFUNDIMTAR QË VENDOS SE SHKELJA KA NDODHUR NË FAKT.

6. Pasojat e ushtrimit të kompetencave të përmendura në pikën 1 për kontratën e lidhur pasi është shpallur fituese përcaktohen nga legjislacioni kombëtar. Gjithashtu, përveçse kur vendimi duhet të shfuqizohet përpara dëmshpërblimit, Shteti Anëtar mund të parashikojë që, pas lidhjes së një kontrate, kompetencat e organit përgjegjës për procedurat e shqyrtimit të kufizohen me dhënien e dëmshpërblimit ndaj personit të prekur nga një shkelje.

7. Nëse bëhet një kërkesë për dëmshpërblim, që paraqet kostot e përgatitjes së një oferte ose të pjesëmarrjes në një procedurë prokurimi, personit që bën kërkesën i kërkohet vetëm të provojë shkelje të së drejtës komunitare në fushën e prokurimit ose rregullave kombëtare në zbatim të kësaj të drejte dhe që ai do të kishte pasur mundësinë reale për të fituar kontratën dhe që, për shkak të asaj shkeljeje, kjo mundësi është cenuar negativisht;

8. Shtetet Anëtare sigurojnë që vendimet e marra nga organet përgjegjëse shqyrtuese zbatohen me efektshmëri.

9. Duke pasur parasysh se organet përgjegjëse për procedurat e shqyrtimit nuk kanë natyrë gjyqësore, vendimet e tyre gjithmonë arsyetohen me shkrim. Gjithashtu, në këtë rast, duhet parashikuar garantimi i procedurave sipas të cilave nëse pretendohet se organi shqyrtues ka marrë një vendim të paligjshëm e ose ka ushtruar gabim kompetencat që i janë dhënë, këto mund t'i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor ose shqyrtimit nga një organ tjetër që është gjykatë ose tribunal sipas kuptimit të nenit 177 të Traktatit, dhe që është i pavarur si nga autoriteti kontraktues ashtu dhe organi shqyrtues.

Anëtarët e organit të pavarur të përmendur në pikën e parë emërohen në detyrë dhe largohen nga detyra sipas të njëjtave kushte si anëtarët e gjyqësorit sa u takon autoritetit përgjegjës për emërimin e tyre, periudhës së qëndrimit në detyrë dhe largimit të tyre. Të paktën kryetari i këtij organi të pavarur ka të njëjtat kualifikime ligjore dhe profesionale me anëtarët e gjyqësorit. Organi i pavarur i merr vendimet sipas një procedure ku dëgjoen të dyja palët dhe këto vendime, me anë të mjeteve të përcaktuara nga çdo Shtet Anëtar, janë ligjërisht të detyrueshme.

KREU 2 Vërtetimi

Neni 3

Shtetet Anëtare u japin autoriteteve kontraktuese mundësinë për t'iu drejtuar sistemit vërtetues sipas neneve 4 deri në 7.

Neni 4

Autoritetet kontraktuese mund të kenë procedurat dhe praktikat e tyre të prokurimit, të cilat përfshihen në fushën e veprimit të Direktivës 90/531/KEE të shqyrtuara në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim marrjen e një vërtetimi që vërteton se në kohën e tyre, këto procedura dhe praktika kanë qenë në përputhje me të drejtën komunitare në lidhje me dhënien e kontratave dhe rregullave kombëtare në zbatim të së drejtës.

Neni 5

1. Vërtetuesit i raportojnë me shkrim autoritetit kontraktues rezultatet e shqyrtimit të tyre. Ato, përpara se t'i japin autoritetit kontraktues vërtetimin e përmendur në nenin 4, sigurohen që çdo parregullsi e identifikuar në procedurat dhe praktikat e prokurimit të autoritetit kontraktues të jetë korrigjuar, dhe të jenë marrë masat për të siguruar mospërsëritjen e parregullsive.

2. Autoritetet kontraktuese që e kanë marrë vërtetimin mund të përfshijnë në njoftimin e publikuar në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane deklaratën e mëposhtme sipas neneve 16 deri në 18 të Direktivës 90/531/KEE:

“Autoriteti kontraktues ka marrë një vërtetim në përputhje me Direktivën e Këshillit 92/531/KEE që, më, procedurat dhe praktikat e shpalljes së kontratës fituese kanë qenë në përputhje me të drejtën komunitare dhe rregullat kombëtare në zbatim të kësaj të drejte.”

Neni 6

1. Vërtetuesit janë të pavarur nga autoritetet kontraktuese dhe duhet të jenë tërësisht objektivë në kryerjen e detyrave të tyre. Ata ofrojnë garancitë e duhura të kualifikimeve të rëndësishme profesionale dhe përvojës.

2. Shtetet Anëtare mund të identifikojnë çdo person, profesion ose institucion, stafin e të cilëve, të thirrur si vërtetues, e gjykojnë se përmbush kërkesat e pikës 1. Për këto qëllime, Shtetet Anëtare mund të kërkojnë kualifikime profesionale, të paktën në nivel të diplomës së lartë, sipas kuptimit të Direktivës

89/48/KEE [8], që e gjykojnë të rëndësishme, ose të parashikojnë që këto garanci të ofrohen nga provimet e veçanta për aftësi profesionale të organizuara ose të njohura nga shteti.

Neni 7

Dispozitat e nenit 4, 5 dhe 6 gjykojnë kërkesa thelbësore për zhvillimin e standardeve europiane mbi vërtetimin.

KREU 3 Mekanizmi korrigjues

Neni 8

1. Komisioni mund të përdorë procedurat që i parashikon ky nen nëse, përpara lidhjes së një kontrate, gjykon se është kryer një shkelje e qartë dhe flagrante e dispozitave komunitare në fushën e prokurimit gjatë një procedure prokurimi brenda fushës së veprimit të Direktivës 90/531/KEE, ose në lidhje me nenin 3 pika 2 shkronja (a) të asaj direktive në rastin e autoriteteve kontraktuese për të cilat zbatohet ajo dispozitë.

2. Komisioni njofton Shtetet Anëtare dhe autoritetin kontraktues përkatës për arsyet që e kanë çuar në përfundimin se është kryer një shkelje e qartë dhe flagrante dhe kërkon korrigjimin me mjete të duhura.

3. Brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit të përmendur në pikën 2, Shtetet Anëtare përkatëse i komunikojnë Komisionit:

(a) një konfirmim prej tij që shkelja është korrigjuar; ose

(b) një parashtrim të arsyetuar se pse nuk është bërë asnjë korrigjim; ose

(c) një njoftim që procedura e prokurimit është pezulluar ose nga autoriteti kontraktues me nismën e vet ose mbi bazën e kompetencave të specifikuara në nenin 2 pika 1 shkronja (a).

4. Një parashtrim i arsyetuar në përputhje me paragrafin 3 shkronja (b) mund të mbështetet, mes çështjesh të tjera, në faktin që shkelja e pretenduar është tashmë subjekt i procedurave të shqyrtimit gjyqësor ose të një shqyrtimi, siç përmendet në nenin 2 pika 9. Në këtë rast, Shteti Anëtar njofton Komisionin për rezultatin e këtyre procedurave sapo rezultati bëhet i ditur.

5. Nëse jepet njoftim që procedura e prokurimit është pezulluar në përputhje me paragrafin 3 shkronja (c), Shteti Anëtar përkatës njofton Komisionin për heqjen e pezullimit ose për fillimin e një tjetër procedure prokurimi, e cila lidhet tërësisht ose pjesërisht me të njëjtin objekt. Ky njoftim i ri konfirmon që shkelja e pretenduar është korrigjuar ose përmban një parashtrim të arsyetuar se pse nuk është bërë korrigjimi.

KREU 4 Pajtimi

Neni 9

1. Çdo person që ka ose ka pasur interes në fitimin e një kontrate të veçantë brenda fushës së veprimit të Direktivës 90/531/KEE dhe që, në lidhje me procedurën për fitimin e asaj kontrate, gjykon që është dëmtuar ose rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar e së drejtës komunitare në fushën e prokurimit ose rregullave kombëtare që e zbatojnë atë të drejtë, mund të kërkojë zbatimin e procedurës së pajtimit të parashikuar në nenet 10 dhe 11.

2. Kërkesa e përmendur në pikën 1 i drejtohet me shkrim Komisionit ose autoriteteve kombëtare të renditura në shtojcë. Këto autoritete ia përcjellin kërkesat Komisionit sa më shpejt që të jetë e mundur.

Neni 10

1. Nëse Komisioni gjykon, në bazë të kërkesës të përmendur në nenin 9, që mosmarrëveshja ka të bëjë me zbatimin korrekt të së drejtës komunitare, i kërkon autoritetit kontraktues të shprehet nëse është i gatshëm të marrë pjesë në procedurën e pajtimit. Nëse autoriteti kontraktues refuzon të marrë pjesë, Komisioni njofton personin që ka bërë kërkesën se procedura nuk mund të fillojë. Nëse autoriteti kontraktues bie dakord, zbatohen pikat 2 deri në 7.

2. Komisioni propozon, sa më shpejt që të jetë e mundur, një pajtues të nxjerrë nga lista e personave të pavarur, të akredituar për këtë qëllim. Kjo listë hartohet nga Komisioni, pas konsultimit me Komitetin Këshillimor për Kontratat Publike ose, në rastin e autoriteteve kontraktuese veprimtaritë e të cilave përcaktohen në nenin 2 pika 2 shkronja (d) të Direktivës 90/531/KEE, pas konsultimit të Komitetit Këshillimor për Prokurimin në sektorin e telekomunikacioneve.

Çdo palë në procedurën e pajtimit deklaron nëse e pranon pajtuesin dhe cakton një pajtues shtesë. Pajtuesit mund të ftojnë jo më shumë se dy persona të tjerë si ekspertë për t'i këshilluar ata në punën e tyre. Palët në procedurën e pajtimit dhe Komisioni mund të refuzojnë çdo ekspert të ftuar nga pajtuesit.

3. Pajtuesit i japin personit që kërkon zbatimin e procedurës së pajtimit, autoritetit kontraktues dhe çdo kandidati ose ofertuesi tjetër që merr pjesë në procedurën përkatëse të prokurimit, mundësinë për ta paraqitur çështjen me shkrim ose më gojë.

4. Pajtuesit përpiqen sa më shpejt që të jetë e mundur të arrijnë ndërmjet palëve një marrëveshje që është në përputhje me të drejtën komunitare.

5. Pajtuesit i raportojnë Komisionit për gjetjet e tyre dhe për çdo rezultat të arritur.

6. Personi që kërkon zbatimin e procedurës së pajtimit dhe autoriteti kontraktues kanë të drejtë ta përfundojnë procedurën në çdo kohë.

7. Nëse palët nuk vendosin ndryshe, personi që kërkon zbatimin e procedurës së pajtimit dhe autoriteti kontraktues janë përgjegjës për kostot e tyre. Gjithashtu, ato përballojnë secili kostot e procedurës, duke përjashtuar koston e palëve ndërhyrëse.

Neni 11

1. Autoriteti kontraktues vë në dijeni pajtuesit nëse, në lidhje me një procedurë të veçantë prokurimi, një person i interesuar sipas kuptimit të nenit 9, i ndryshëm nga personi që kërkon procedurën e pajtimit, ndjek procedurën e shqyrtimit gjyqësor ose procedura të tjera shqyrtimi sipas kuptimit të kësaj direktive. Pajtuesit e vënë në dijeni personin për kërkesën që është bërë për të zbatuar procedurën e pajtimit dhe e ftojnë të bëjë të ditur, brenda një afati të caktuar, nëse pranon të marrë pjesë në procedurë. Nëse personi refuzon të marrë pjesë, pajtuesit mund të vendosin, nëse është e nevojshme me shumicë, ta përfundojnë procedurën e pajtimit kur gjykojnë që pjesëmarrja e personit është e nevojshme për të zgjidhur mosmarrëveshjen. Ata i bëjnë të ditur Komitetit vendimin e tyre dhe japin arsye në lidhje me këtë.

2. Veprimi i marrë sipas këtij kreu nuk cenon:

(a) asnjë veprim që Komisioni ose një Shtet Anëtar ndërmerr sipas neneve 169 ose 179 të Traktatit ose sipas Kreut 3 të kësaj direktive;

(b) të drejtat e personave që kërkojnë procedurë pajtimi, të autoriteteve kontraktuese ose të një personi tjetër.

KREU 5 Dispozita të fundit

Neni 12

1. Komisioni, jo më vonë se katër vjet pas zbatimit të kësaj direktive, në konsultim me Komitetin Këshillimor për Kontratat Publike, shqyrton mënyrën se si janë zbatuar dispozitat e kësaj direktive dhe sidomos përdorimin e standardeve europiane, dhe, nëse është e nevojshme, bën propozime për ndryshime.

2. Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit, përpara datës 1 mars të çdo viti, informacion për funksionimin e procedurave të tyre kombëtare të shqyrtimit gjatë vitit kalendarik të fundit. Natyra e informacionit përcaktohet nga Komisioni në konsultim me Komitetin Këshillimor për Kontratat Publike.

3. Komisioni, në rastin e çështjeve në lidhje me autoritetet kontraktuese, veprimtaritë e të cilave përcaktohen në nenin 2 pika 2 shkronja (d) të Direktivës 90/531/KEE, konsultohet gjithashtu me Komitetin Këshillimor për Prokurimin në sektorin e telekomunikacioneve.

Neni 13

1. Shtetet Anëtare marrin masat e nevojshme për respektimin e kësaj direktive përpara datës 1 janar 1993. Mbretëria e Spanjës i merr këto masa jo më vonë se data 30 qershor 1995. Republika Greke dhe Republika Portugeze i marrin këto masa jo më vonë se data 30 qershor 1997. Shtetet Anëtare njoftojnë menjëherë Komisionin për këto masa.

Kur Shtetet Anëtare i miratojnë këto masa, ato përmbajnë një referencë për këtë direktivë ose shoqërohen nga kjo referencë me rastin e publikimit të tyre zyrtar. Mënyra e referimit vendoset nga Shtetet Anëtare.

2. Shtetet Anëtare zbatojnë masat e përmendura në pikën 1 më të njëjtat data si ato (që përcakton Direktiva 90/531/KEE).

3. Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit tekstet e dispozitave kryesore të së drejtës së brendshme që miratojnë në fushën që rregullon kjo direktivë.

Neni 14

Kjo direktivë u drejtohet Shteteve Anëtare.

Nënshkruar në Bruksel, më 25 shkurt 1992.

Për Këshillin

Presidenti

Vitor MARTINS

[1] GZ nr. C 216, 31.08.1990, fq. 8; dhe GZ nr. C 179, 10.07.1991 fq. 18.

[2] GZ nr. C 106, 22.04.1991, fq. 82; dhe GZ nr. C 39, 17.02.1992.

[3] GZ nr. C 60, 08.03.1991, fq. 16.

[4] GZ nr. L 297, 29.10.1990, fq. 1.

[5] GZ nr. L 395, 30.12.1989, fq. 33.

[6] GZ nr. L 185, 16.08.1971, fq. 5.

[7] GZ nr. L 13, 15.01. 1977, fq. 1.

[8] GZ nr. L 19, 24.01.1989, fq. 16.

SHTOJCË

Autoritetet kombëtare të cilave mund t'u drejtohet kërkesa për procedurën e pajtimit e përmendur në nenin 9

Belgjikë, Services du Premier Ministre
Diensten Van de Eerste Minister
Ministère des Affaires économiques
Ministerie van Economische Zaken

Danimarkë, Industri- og Handelsstyrelsen (kontrata furnizimi)
Boligsministeriet (kontrata për punime)

Gjermani, Bundesministerium fuer Wirtschaft

Greqi, Ypoyrgeio Viomichanias, Energeias kai Technologias
Ypoyrgeio Emporioy Ypoyrgeio Perivallontos, Chorotaxias kai Dimosion Ergon

Spanjë, Ministerio de Economía y Hacienda

Francë, Commission centrale des marchés

Irlandë, Department of Finance

Itali, Presidenza del Consiglio dei Ministri Politiche Comunitarie

Luksemburg, Ministère des travaux publics

Vendet e Ulëta, Ministerie van Economische Zaken

Portugali, Conselho de mercados de obras publicas e particulares

Mbretëria e Bashkuar, HM Treasury